



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1350/prot.
2

Tiranë më 26.12.2017

REKOMANDIM

Nr. 50, datë 26.12.2017

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Baza Ligjore: Ligji Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Ligji Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Në zbatim të Urdhrit nr. 255 datë 12.10.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (I.E.V.P.) "Mine Peza" me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të I.E.V.P. "Mine Peza".

Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale "Mine Peza" është institucion varësie i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe ka për qëllim garantimin e masave të sigurisë, realizimin e trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve, zbatimin e programeve të rehabilitimit dhe riintegrit, zbatimin e politikave shëndetësore si dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. I.E.V.P. "Mine Peza" është i kategorizuar në dy seksione: një i sigurisë së lartë dhe tjetri i sigurisë së zakonshme.

Drejtoria e Hetimit Administrativ, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e I.E.V.P. "Mine Peza", të cilët ishin njohur me Urdhrin e Komisionerit për kryerjen e hetimit administrativ.

Gjatë hetimit administrativ të ushtruar dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga përfaqësuesit e I.E.V.P. "Mine Peza", është konstatuar:

1. Në dosjet e personelit konstatohet ekzistenca e formularit: "Fleta Prezantuese e Dosjes Teknike të Nëpunësit Civil dhe Anketa Personale". Formularët e plotësuar (dhe në proces) përmbajnë kategori të dhënash personale për punonjësit e Institucionit, tepër të detajuara (ekzaminime mjekësore, karakteristika fizike si grupi

i gjakut, ngjyra e syve, referime për kredi të marra etj.), lidhjet me jashtë, referimet për kreditin, masat disiplinore, përdorimi i alkolit, drogës dhe shëndeti mendor etj. Formularët aplikohen për të gjithë punëmarrësit me status civil dhe policor. Në rubrikën 20 të "Anketës Personale" perifrazohet: "Deklaroj se të dhënat e mia personale janë dhënë me pëlqimin tim, në zbatim të kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale...". Sa më sipër konkludohet se:

- i. Për shkak të natyrës së funksionimit, kontrolluesi mund të përpunojë të dhëna personale nëse ato janë thelbësore për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të tij, megjithatë në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale nuk mund të jetë në kundërshtim të hapur me të drejtën e subjektit të të dhënave për mbrojtjen e jetës personale dhe private.
- ii. Zyra e Komisionerit e konsideron të tepërt plotësimin e anketës në mënyrë kaq të hollësishme dhe konkludon se kontrolluesi nuk ka respektuar detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 27 të Rregullores "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve" miratuar me Urdhrin nr. 3125/1 datë 4.9.2009 të Ministrit të Drejtësisë, nenin 5 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24 të Komisionerit datë 27.12.2012 "Për detyrimet e kontrolluesve përpara se të përpunojnë të dhëna personale".
- iii. Referuar nenit 3 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar "Pëlqim i subjekteve të të dhënave" është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij. Në rastin konkret, dhënia e pëlqimit nuk mund të jetë në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Zyra e Komisionerit konkludon se, subjektet e të dhënave "punëmarrës" me status civil dhe policor nuk e kanë dhënë pëlqimin për arsye se plotësimi i "Anketës Personale" është kryer në mënyrë jo vullnetare. Dhënia e pëlqimit konsiderohet si e tillë në rastin kur subjekti i të dhënave ka mundësinë dhe të drejtën e refuzimit të deklaramit të të dhënave. Përpunimi i të dhënave personale në mënyrë të ligjshme (sipas dispozitave të Kreut të Dytë të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008) është detyrim ligjor i kontrolluesit.

Konstatimi përbën shkelje administrative të dispozitave të Kreut të Dytë të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

2. Kontrolluesi I.E.V.P. "Mine Peza" mbikëqyr ambientet e brendshme dhe të jashtme të godinës së administratës dhe regjimit të brendëshëm, nëpërmjet sistemit të video-survejmimit. Zyra e Komisionerit ka konstatuar se I.E.V.P. "Mine Peza" nuk informon subjektet e të dhënave "vizitorë" dhe "punëmarrës", mbi përpunimin e të dhënave personale "imazhe-video" nëpërmjet sistemit të Video-Vëzhgimit (CCTV) si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre.

Zyra e Komisionerit ka miratuar nëpërmjet Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" modelin standard të tabelës informuese, duke ju vënë në dispozicion kontrolluesve një mekanizëm standard për t'ju mundësuar subjekteve të të dhënave informimin mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit CCTV si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre në raste çënimi.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit: "Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij."

3. I.E.V.P. "Mine Peza" nuk disponon Rregulloren "Për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale" miratuar me Urdhrin nr. 496 datë 28.09.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar: "2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregulloren të tjera."

4. Nga verifikimi i dokumentacionit personal të punësimit të personelit civil dhe policor, është konstatuar se I.E.V.P. "Mine Peza" nuk ka marrë masa për "ruajtjen e konfidencialitetit" nga punëmarrësit të cilët, për shkak të detyrës dhe përshkrimit të pozicionit të punës, kanë akses në mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit ka miratuar nëpërmjet Vendimit nr. 6 datë 05.08.2013 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale" modelin standard të "Deklaratës së Konfidencialitetit", duke u mundësuar kontrolluesve një mekanizëm për të angazhuar nëpunësit në "ruajtjen e konfidencialitetit" në lidhje me të dhënat që ata aksesojnë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar: "Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj".

Konstatimet e mësipërme në tërësinë e tyre përbëjnë tejkalim të mbledhjes së informacionit të kërkuar në zbatim të Ligjit nr. 10 032/2008 "Për policinë e burgjeve", Rregullores "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve" miratuar me Urdhrin nr. 3125/1 datë 4.9.2009 të Ministrit të Drejtësisë, Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe

Udhëzimit nr. 24 të Komisionerit datë 27.12.2012 "*Për detyrimet e kontrolluesve përpara se të përpunojnë të dhëna personale*".

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit ka mbajtur procesverbalin të cilin e lexoi në prani të përfaqësuesit të I.E.V.P. "*Mine Peza*", i cili e nënshkroi duke mos paraqitur pretendime.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" dhe në respektim të së drejtës për tu dëgjuar sa i përket shkeljeve të konstatuara, Zyra e Komisionerit ka organizuar një seancë dëgjimore në të cilën është ftuar I.E.V.P. "*Mine Peza*" dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si organ epror. Deri në ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore I.E.V.P. "*Mine Peza*" nuk kishte rikuperuar shkeljet e konstatuara.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit mban në konsideratë faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e kontrollit gjatë hetimit administrativ.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 27, 28, 29, 30, 31 dhe 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi I.E.V.P. "*Mine Peza*", në zbatim të neneve 5, 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të ndalojë procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale për subjektet "*punëmarrës*" nëpërmjet formularit: "*Fleta Prezantuese e Dosjes Teknike të Nëpunësit Civil dhe Anketa Personale*" si dhe të shkatërrojë të dhënat personale të tepërta, brenda periudhës 30 ditore nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.
2. Kontrolluesi I.E.V.P. "*Mine Peza*", në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të standartizojë tabelat informuese për subjektet e të dhënave në lidhje me informimin mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre në raste cënimi, sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri nëpërmjet Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*";
3. Kontrolluesi I.E.V.P. "*Mine Peza*", në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar të marrë masa të përshtatshme për zbatimin e Rregullores "*Për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale*" miratuar me Urdhrin nr. 496 datë 28.09.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve;
4. Kontrolluesi I.E.V.P. "*Mine Peza*", në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të marrë masa për ruajtjen e konfidencialitetit nëpërmjet nënshkrimit të "*Deklaratës së*

Konfidencialitetit" nga punëmarrësit të cilët, për shkak të detyrës dhe përkrahimit të pozicionit të punës, kanë akses në mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

5. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, I.E.V.P. "*Mine Peza*" të kryejë plotësimin e detyrimeve të parashikuara në këtë Rekomandim brenda afatit 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni, dhe të njoftojë me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për masat e marra. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit.
6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 26.12.2017

